



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika l të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, pika 1.2.1. të Ligjit nr. 06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën, nenit 17 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2. i Ligjit nr. 04/L-125, për shëndetësi, si dhe dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2022, merr këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E POLIKLINIKËS STOMATOLOGJIKE SPECIALISTIKE TË KRYEQYTETIT

Neni 1 Qëllimi

Themelohet Poliklinika Stomatologjike Specialistike për ofrimin e shërbimeve specialistike stomatologjike për qytetarët e Kryeqytetit.

Neni 2 Statusi juridik i poliklinikës

Poliklinika Stomatologjike Specialistike e Kryeqytetit e ka statusin e personit juridik dhe do të jetë në varësi dhe mbikëqyrje të Drejtorisë së Shëndetësisë të Kryeqytetit.

Neni 3
Shërbimet e ofruara

Poliklinika stomatologjike do të ofrojë shërbime specialistike në të gjitha fushat e stomatologjisë që i përkasin nivelit sekondar.

Neni 4

Organizimi dhe veprimtaria e Poliklinikës Stomatologjike nga paragrafi 1. i këtij vendimi, përcaktohet me Statut.

Neni 5

Miratimi i Statutit

Brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh, Drejtoria e Shëndetësisë e Kryeqytetit obligohet që Kuvendit të Kryeqytetit t'ia propozojë për miratim Statutin e Poliklinikës Stomatologjike Specialistike të Kryeqytetit.

Neni 6

Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Kryeqytetit dhe Drejtoria e Shëndetësisë, si dhe organet e tjera relevante.

Neni 7

Hyrja ne fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-510/02-257541/22, më 25.11.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

